

Nr. Prot. 021/B/19

VENDIM Nr. 1336

Për

Fillimin e Procesit të Konsultimit Publik të dokumenteve për Analizën e ‘Tregjeve me Pakicë dhe ato të Interkoneksionit në Rrjetet e Telefonisë Fikse’

Në mbështetje të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike, neni 10, paragrafi 5), neni 31, paragrafi 8), neni 79, paragrafi 1) dhe 2) dhe neni 82 paragrafi 1) dhe 3) (*tutje referuar si - Ligji*); Rregullores Nr. 27 për Analizat e Tregut (*Ref. ARKEP Nr. Prot. 041/B/14*), neni 3, paragrafët 1), 3) dhe 4), neni 4, paragrafët 3.8) dhe 3.9) (*tutje referuar si; Rregullorja për Analizat e Tregut*) dhe neni 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të (*Ref. Nr.Prot.054/B/17*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si; ARKEP ose Autoriteti*), Bordi Drejtues i Autoritetit në përbërje prej:

- 1) z. Kreshnik Gashi Kryetar
- 2) z. Nijazi Ademaj Anëtar
- 3) z. Hazir Hajdari Anëtar
- 4) z. Bahri Anadolli Anëtar

në mbledhjen e 35-të me radhë të mbajtur me datë 28 Shkurt 2019, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe rekomandimit të paraqitur nga Departamenti i Komunikimeve Elektronike (DKE) dhe DL, vendosi si më poshtë:

V E N D I M

I. Miratohet fillimi i Konsultimit Publik të:

- a) Draft Vendimi për Përcaktimin e Tregut për ‘Qasje në rrjetin publik telefonik në lokacione fikse’
- b) Draft Vendimi për Përcaktimin e Tregut për ‘Shërbimet telefonike lokale dhe/ose kombëtare të disponueshme për publikun të ofruara në lokacionin fiks’
- c) Draft Vendimi për Përcaktimin e Tregut për ‘Shërbimet telefonike ndërkombëtare të disponueshme për publikun të ofruar në lokacionin fiks’

- d) Draft Vendimi për Përcaktimin e Tregut për 'Originimin e thirrjeve në rrjete publike telefonike të ofruara në një lokacion fikse'
 - e) Draft Vendimi për Përcaktimin e Tregut për 'Terminimin e thirrjeve për rrjete publike telefonike individuale të ofruara në lokacionin Fiks'
 - f) Draft Vendimi për Përcaktimin e Tregut për 'Shërbimet transite në rrjetet telefonike publike fikse'
 - g) Draft Vendimin për Anulimin e detyrimeve rregullatore për ndërmarrjen Telekomit i Kosovës Sh.A si Ofrues me Fuqi të ndjeshme në Tregjet e Telefonisë Fikse
 - h) Draft Vendimi për Përcaktimin e ndërmarrjes Telekomit i Kosovës Sh.A. si OFNT në tregun e 'Terminimit të thirrjeve për rrjete publike Telefonike individuale të ofruara në Lokacionin Fiks'
 - i) Draft Vendimi për Përcaktimin e ndërmarrjes Telekomit i Kosovës Sh.A. si OFNT në tregun e 'Shërbimeve transite kombëtare në rrjetin publik telefonik në lokacion fikse'
 - j) Draft Vendimi për Përcaktimin e ndërmarrjes IPKO Telecommunications LLC si OFNT në tregun e 'Terminimit të thirrjeve për rrjete publike Telefonike individuale të ofruara në Lokacionin Fiks'
 - k) Draft Vendimi për Përcaktimin e ndërmarrjes "mts" d.o.o. si OFNT në tregun e 'Terminimit të thirrjeve për rrjete publike Telefonike individuale të ofruara në Lokacionin Fiks'
 - l) Draft Vendimi për Përcaktimin e ndërmarrjes Kujtesa.Net Sh.P.K. si OFNT në tregun e 'Terminimit të thirrjeve për rrjete publike Telefonike individuale të ofruara në Lokacionin Fiks'
 - m) Raporti për Analizën e Tregut të Telefonisë fikse dhe Përcaktimin e Operatëve me Fuqi të Ndjeshme në Treg (OFNT)
- II. Procesi i konsultimit publik fillon nga data **14 Mars 2019** dhe përfundon më datë **13 Prill 2019**.
- III. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 5) përcakton se Autoriteti: *"Miraton vendimet në lidhje me 7 përcaktimin e tregjeve përkatëse, kryen analizat e tregut dhe imponimin, si dhe tërheqjen e obligimeve të rregullatorit tek operatorët me fuqi të ndjeshme tregu."*

ARKEP me Vendimin nr. 1194 (Ref. Nr.Prot. 30/B/2018; dt. 22/05/2018) ka inicuar procesin e analizës së tregjeve me pakicë dhe ato të interkoneksionit në rrjetet e telefonisë fikse nga data 01 Qershor 2018 deri më 30 Shtator 2018.

Me Vendimet nr. 1253 dhe 1335 ka vazhduar procesin e Analizës së tregjeve me pakicë dhe ato të interkoneksionit në rrjetet e telefonisë fikse.

Gjatë procesit të Analizës së Tregut 'Origjinimi i Thirrjeve për rrjete publike Telefonike individuale të ofruara në Lokacionin Fiks', ARKEP i ka dërguar pyetësorët operatorëve: të telefonisë fikse: "Telekomit të Kosovës" SH.A., "IPKO Telecommunications" LLC, "Kujtesa.NET" SH.P.K. dhe "mts" d.o.o.

Neni 82 paragrafi 1) i Ligjit përkufizon se Autoriteti gjatë aprovimit të akteve normative duhet t'i publikojë ato në pajtim me kushtet dhe procedurat e vendosura nga Autoriteti, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

Andaj, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 14/03/2019

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

**Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit**

Aktivendimi i dërgohet:

- Operatorëve të rrjetit dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik/Departamenti i Postë Telekomunikacionit dhe Teknologjisë Informative
- Autoritetit Kosovar të Konkurrencës
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike/Zyra për Analiza Ekonomike, ARKEP,
- Departamenti ligjor, ARKEP,
- Arkivit, ARKEP